



Pranuar / Dorezuar Priniljeno/Prodato Received/Delivery	31. 01 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM48HCK	417/20	22	1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1194/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën numër A.nr.1194/2021 të datës 17.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër Vendimit Nr.prot:11/2021 të datës 03.12.2021 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 31.01.2022 mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1194/2021 e datës 17.12.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.prot:11/2021 i datës 03.12.2021 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

**A r s y e t i m**

Ankuesi nëpunës civil pranë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), me datë 03.12.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 6205/2021 të regjistruar me numër A.nr.1194/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.11/2021 të datës 03.12.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmes të cilit ankuesit i është refuzuar ankesa si e pa bazuar lidhur me aplikacionin e dorëzuar për pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Këshilli, me datë 14.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës, ndërsa përmes e-maili të datës 17.01.2022 ka pranuar prova shtesë lidhur me ankesën e datës 17.12.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.01.2022 ka nxjerr vendim për bashkimin e ankesës A.nr.8996/2021 të datës 02.12.2021 me ankesën A.nr.1194/2021 të datës 17.12.2021 të parashtruar nga ankuesi

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën ankuesit të datës 17.12.2021 me numër protokolli 6205/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përshkrimi i detyrave të punës së ankuesit; Njoftimin e datës 26.11.2021; Vendimin e datës 26.11.2021 me numër prot:34/2021 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP-MPB; Vendimin e datës 03.12.2021 me numër prot:11/2021 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP-MPB; E-mailin e datës 17.01.2022 dërguar nga Sh.L për KPMSHCK i protokolluar me numër:177/2022; Vendimin e datës 25.11.2021 me numër prot:31/2021 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP-MPB; Ankesën e ankuesit të datës 29.11.2021 dërguar përmes e-maili tek në Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP-MPB; Rregulloren Nr.03/2010 për Organizmin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës; Ankesën e ankuesit të datës 02.12.2022 të të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me E-mailin e datës 01.12.2021 dërguar nga ankuesi për KPMSHCK me korrespondencën e bashkangjitur prej 64 faqesh; vendimin nr. Ref:127/2021 të qeverisë së republikës së Kosovës të datës 27.08.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.12.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 14.12.2021; E-mailin e datës 13.12.2021 dërguar nga R.K për A.B me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 (tre) faqesh; Aplikacionin e ankuesit; Vendimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë i datës 05.09.2018; Vendimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë i datës 25.08.2015; Vendimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë i datës 29.01.2015; Diplomën e ankuesit me numër 2451 të datës 14.03.1997; Vendimin e datës 28.03.2017 të lëshuar nga Këshilli Shtetëror për Njohje/MASHT; Akt emërimit të ankuesit të datës 21.03.2012; Kontratën e ankuesit të datës 06.05.2003 lëshuar nga UNMIK; Kontratën e ankuesit të datës 12.01.2004 lëshuar nga UNMIK; Kontratën e ankuesit të datës 01.08.2006 lëshuar nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse; Kontratën e ankuesit të datës 03.01.2007 lëshuar nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse; Kontratën e ankuesit të datës 28.12.2007 lëshuar nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse; Kontratën e ankuesit të datës 30.03.2010; Vendimin e datës 31.01.2006 me numër:185; Kontratën e ankuesit të datës 22.02.2006 lëshuar nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse; Kontratën e ankuesit të datës 25.01.2005 lëshuar nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse; Kontratën e punës së ankuesit të datës 18.01.2011; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2019; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 26.01.2021; Vërejtjen me shkrim të datës 23.09.2021 ; Letër motivimin e datës 11.11.2021; Certifikatën e datës 12.10.2021 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë; Certifikatën e datës 07.12.2012; Certifikatën e datës 18.04.2007; Certifikatën e datës 17.08.2007; Certifikatën e datës 28.10.2004; Certifikatën e datës 31.03.2015; Certifikatën e datës 30.05.2016; E-mailin e datës 16.12.2021 me provat e dërguara shtesë nga Arkiva e MPB-së; Konkursin e datës 30.09.2021; E-mailin e datës 26.11.2021 dërguar nga Sh.H për ankuesin; E-mailin e datës 30.11.2021 dërguar nga ankuesi për Sh.H me korrespondencën e bashkangjitur prej dy faqesh;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është *e pabazuar, sepse:*

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 30.09.2021 ka publikuar konkursin për pozitën e punës *Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë*, me numër reference RN000007680.

Me datë 08.11.2021, ankuesi ka aplikuar në pozitën përkatëse të punës, ku si dëshmi është aplikacioni me numër RAN0001317. Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me datë 26.11.2021 ka nxjerrë Vendimin Nr.prot:34/2021 përmes të cilit ka refuzuar aplikacionin e ankuesit me arsyetimin se i njëjti nuk është nëpunësit civilë ekzistues i kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në Shërbimin Civil.

I pakënaqur me Vendimin Nr.34/2021 të datës 26.11.2021 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ankuesi me datë 29.11.2021 ka parashtruar ankesë të organi i njëjtë, gjegjësisht Divizion për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ky i fundit me datë 03.12.2021 ka nxjerr Vendimin me Nr.11/2021 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit me arsyetimin se pozita e Koordinatorit të Zyrës Regjionale në Mitrovicë sipas dispozitave ligjore në fuqi për nëpunësit civil nuk është pozite e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues ashtu siç kërkohet në konkurs.

Kundër këtij vendimi, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës të dërguara nga palët në procedurë konstatoi se ankuesi në kohën e aplikimit për pozitën e punës *Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë*, me numër reference RN000007680, ka qenë duke ushtruar detyrën e Koordinatorit të Zyrës Regjionale në Mitrovicë.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji analizoj dispozitat e Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të lartë Drejtues, përkatësisht nenin 6 paragrafi 5 ku përcaktohet se: *5. Njoftimi për shpalljen e konkursit për herë të parë është për nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil....*", Rregulloren Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Në pajtim me Ligjin, pozitat e punës në shërbimin civil të Kosovës ndahen në këto kategori funksionale: 1.1. Kategoria e Lartë Drejtuese; 1.2. Kategoria e Mesme Drejtuese; 1.3. Kategoria e Ulët Drejtuese, dhe 1.4. Kategoria Profesionale*" si dhe Shtojcën Nr.01-Përshkrimi i përgjithshëm i punës për secilën klasë në shërbimin civil, dhe rrjedhimisht konstatoi se pozita e Koordinatorit të cilën aktualisht është duke e ushtruar ankuesi nuk hynë në kuadër të pozitave të kategorisë së lartë apo të mesme drejtuese të përcaktuar me nenin 33 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik. Andaj bazuar si me lartë Kolegji konstaton se Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.34/2021 të datës 26.11.2021 për refuzimin e aplikacionit të ankuesit ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, sepse pozita të cilën e ka ushtruar ankuesi në momentin e aplikimit "*Koordinator i Zyrës Regjionale në Mitrovicë*" nuk hynë në kuadër të pozitave të nivelit të lartë apo të mesëm drejtues në Shërbimin Civil, prandaj edhe nuk ka mundur të aplikojë në

konkursin e brendshëm në të cilin të drejt aplikimi kanë pasur vetëm nëpunësit civil ekzistues të nivelit të lartë apo të mesëm drejtues.

Rrjedhimisht, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë edhe me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.11/2021 të datës 03.12.2021 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, ka konstatuar drejte gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejte ligjin material duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të lartë Drejtues, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.


Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me A.nr.1194/2021**

**Flakron GASHI**

  
Procesmbajtës



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Menaxherit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

